



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
SPITALI RAJONAL “MEMORIAL” FIER
NJËSIA E PROKURIMIT



Nr. _____ Prot.

Fier, më 17.07.2023

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT (PARAPRAK)

Drëjtuar: OE: “**PEGASUS.**” sh.p.k, me adresë: Tiranë, Rruga “Siri Kodra”, tek ish frigoriferi.

Procedura e prokurimit/lotit: “**E hapur mbi kufirin e lartë monetar**”.

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF -67972-05-02-2023**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “**Blerje Kite Reagentë dhe Materiale konsumi për Laboratorin Klinik-Biokimik**” Loti I “**Blerje kite dhe reagent**”, më fond limit : **67 301 415.2** (gjashtëdhjetë e shtatë milion e treqind e një mijë e katërqind e pesëmbëdhjetë pikë dy) lekë pa TVSH / **605 664.28** (gjashtëqind e pesë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjet e katër pikë njëzet e tetë) **EURO**, pa TVSH.

Kohëzgjatja e kontratës: 12 (dymbëdhjetë) muaj.

Publikimet e meparshme (nëse është rasti): **Buletini i Njoftimeve Publike nr. 41 datë 08.05.2023.**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm më këto vlera përkatëse të ofruara:

1. **PEGASUS. sh.p.k**

J62903750A

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera: 64 265 500 (gjashtëdhjetë e katër million e dyqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e pesëqind) lekë pa TVSH.

2. **Medfau sh.p.k** J93610823R
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it

Vlera: 57 803 600 (pesëdhjetë e shtatë milion e tetëqind e tre mijë e gjashtëqind) lekë pa TVSH.

3. **ALMedical** K21511002I
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it

Vlera: 0 (zero) lekë pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. **Medfau sh.p.k** J93610823 Nuk plotësohet Kriteri 1.c - Nuk është paraqitur Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8 si në formë ashtu edhe në përmbajtje. Qendrim i mbajtur edhe nga KPP me Vendimin nr.183 dt.09.03.2023. Nga kërkesat për pajisjet në përdorim, nuk plotësohet pika c “autorizimi i prodhuesit” - është ofruar pajisja Koagulometer CA 600 e prodhuesit Siemens, ndërsa Autorizimi i Prodhuesit është për pajisjen Koagulometer CA 560. Nuk përmbushen specifikimet teknike të kërkuara për pajisjet në përdorim si vijon: Pajisja Analizator Imunologjik: Modeli Advia Centaur XPT e ofruar si pajisje primare dhe si pajisje back-up, nuk plotëson specifikimet: (i) Si pajisje primare, nuk plotëson “Sistem imuno-analizues i automatizuar i cili bazohet në parimin CMA” - ofruar me metodologjinë e kemiluminishencës kimike; (ii) Si pajisje back-up, nuk plotëson “Sistem imuno-analizues i automatizuar i cili bazohet në parimin ELFA”. Pajisja Analizator Hematologjik: Modeli Advia 560 e ofruar si pajisje primare dhe si pajisje back-up, nuk plotëson specifikimin “Vëllimi maksimal i mostrës 15 µl” – pajisja e

ofruar ka vëllim maksimal të mostres 110 µl. Pajisja Analizator për Gazet në Gjak: Modeli Rapid Poit 500, nuk plotëson specifikimin “Mostra e përdorur: 2-3 pika gjak i plotë ose plasmë”. Pajisja Analizator Koagulimi, është ofruar modeli CA 600 por nuk ka autorizim prodhuesi për këtë model por për modelin CA 560. Sidoqofte, edhe modeli CA 600 i ofruar, nuk plotëson specifikimet e kërkuara, konkretisht: (i) “Aparati back up gjysëautomatik” – ofruar të dy aparatet automatik; (ii) “Metodologjia: Sistemi i detektimit I bazuar në viskozitet” – ofruar Photo-optical, continuous, sequential (Clotting/4, chromogenic, * and immunologic*); (iii) “Kapaciteti rreth 100 mostra” – max i ofruar nga pajisja është 60; (iv) “Të ofrojë mundësinë e analizimit prioritar të mostrave STAT” – ofron vetëm 1(STAT 1 priority position); (v) “Të jetë i paisur me të paktën 4 kohëmatës të inkuorporuar në aparat me alarm zanor” – nuk e ofron. Pajisja Analizator Biokimik: Modeli Dimension EXL 200, e ofruar si pajisje primare dhe si pajisje back-up, si pajisje primare nuk plotëson specifikimin “Kapaciteti jo më pak se 800 teste/orë”. Pajisja Analizator Urine: Model i ofruar Clinitec Status, nuk plotëson specifikimin “Kapaciteti rreth 600 stripe urine/ore”

2. **ALMedical**

K21511002I

Nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion ligjor, financiar dhe teknik i kërkuar sipas kërkesave të Dokumentave Standrate të tenderit. Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike. Ka paraqitur vetëm certifikaten ISO 9001.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se OE “PEGASUS.” sh.p.k me adresë: Tiranë, Rruga “Siri Kodra”, tek ish frigoriferi, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 64 265 500 (gjashtëdhjetë e katër milion e dyqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e pesëqind) lekë pa TVSH., totali i pikëve të marra [_____] është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatët e ankimit sipas përcaktimëve në nënin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

TITULLARI I AUTORITËTIT KONTRAKTOR

Rudina Degjoni